



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:039179

Datë: 22.08.2019

Numri i dokumentit: 00472341

P.nr.329/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B nga fshati B.Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1819/13, të datës 31.01.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Pokurorit të Shtetit Ramadan Koro dhe të akuzuarit A.B me datë 13.08.2019 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datën 20.08.2019 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.B, nga i ati R.dhe e ëma A.B e lindur B. i lindur me 14.07.1995, në fshatin B. Komuna e Suharekës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë veprë penale, mbrohet nga liria. me numër personal 1500616136,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 26.08.2013, rreth orës 01:00 min., në S. saktësisht në afërsi të qendrës tregtare “Viva Fresh”, së bashku me me F.B me forcë pengojnë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në atë mënyrë deri sa personi zyrtar – polici E.K në pikën e kontrollit i ka dhënë shenjë për ndalje automjetit të markës “Honday”, me shenjën regjistruese CP-697-JW, të pandehurit duke përdorur shpejtësinë e madhe të automjetit kanë ikur nga vendi i ngjarjes në drejtim të ambulancës së Suharekës, me ç’rast personat zyrtar – policët ndërmarrin veprimin për ndjekjen e të pandehurve në automjetin të markës Honday” e që të pandehurit e kanë braktisur automjetin në afërsi të kafenes “Rochhard”, ku edhe hasen nga ana e policisë.

Me çka ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompenzimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/IL.nr. 1819/2013, të datës 31.01.2014 kundër të akuzuarit A.B nga fshati B.Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Ramadan Koro, i akuzuari ka theksuar se e ka kuptuar në tërësi akuzën dhe e ka pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka pasur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit, nga shikimi dhe leximi i kallëximit penal nr.2013-GB-604 të dt.26.08.2013, shikimi dhe leximi i deklaratës së të akuzuarit të dhënë pranë stacionit policor në Suharekë me dt.26.08.2013 si dhe shkresave tjera të lëndës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi se i njëjti është i pa dënuar më parë, rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË P.nr.329/18 të dt. 20.08.2019

**Bashk. profesional
Feim Bytyqi**

**Gjyqtari
Qemail Suka**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimin, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.